

VENDIM
Nr. 239, datë 26.11.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGE KUÇ”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
HEC “KUÇ”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1930 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 3, dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 144/1 prot., datë 16.11.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Age Kuç’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Age Kuç” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1059 prot., datë 8.11.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Kuç”, me vendndodhje në rrjedhën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të lumit të Shushicës, në afërsi të Fshatit Kuç, Bashkia Himarë, qarku Vlorë.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Age Kuç” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “f”: plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”: plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar.

- Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar,

- **Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:**

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (Vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë); germa “e” (Paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik); germa “g” (Dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti);

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “c” (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (Financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.);

- Dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pika 4.1.2 (Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin) (Prodhuesin e transformatorit, pasi nuk e ka plotësuar në tabelën respektive), do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të “Rregullores

për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Në përfundim të afatit të lejes së shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 3.10.2022), do t’i kërkohej shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Shoqëria duhet të përcjellë informacion në lidhje me pajisjen me leje ndërtimi apo fillimin e mundshëm të punimeve, në mënyrë që të llogaritet edhe vlefshmëria e lejes mjedisore, duke konsideruar afatin 2-vjeçar, që parashikon ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar.

- Shoqëria duhet të specifikojë vitin e ndërtimit të veprës dhe datën konkrete për fillimin e operimit, sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, pasi sa rezulton është shprehur, duke cituar në parim afatet që përcakton kontrata me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Age Kuç” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç”, me kapacitet të instaluar 1930 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti